



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)" (*Komision përgjegjës*)
2. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*Komision për dhënie mendimi*)
3. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" (*Komision përgjegjës*)
4. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin "Programi për infrastrukturën komunale V" (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Lefter Koka, Zef Shtjefni, Halit Valteri, Klajdi Qama dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Ardian Kamenica – Sekretar i Përgjithshëm te Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
Redi Baduni - drejtor te Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
Besmir Beja – Drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë
Irena Malolli – Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Gentjan Sala – Kryetar i AMA-s
Jetmir Braha – Drejtor i Autorizimeve në AKEP
Bleron Dokle – përfaqësues nga AKEP-i
Lindita Sotiri – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Jovan Gjika – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ana Kekezi – Drejtoreshë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ligor Tollsuku – specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot kemi për shqyrtim projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018, për projektin "Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit (DKTI)". Ne jemi komision përgjegjës.

Të ftuar nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit kemi zotin Ardian Kamenicën, sekretar i Përgjithshëm, dhe zotin Redi Paduni, drejtor në këtë ministri.

Fjalën po ia kaloj zotit Kamenica, për një prezantim të shkurtër të marrëveshjes dhe pastaj kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Ardian Kamenica – Përshëndetje!

Të nderuar deputetë, marrëveshja qeveritare mes Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave është për menaxhimin e modernizuar të mbetjeve dhe për ekonominë ricikluese në respekt të mjedisit. Kjo marrëveshje vijon disa marrëveshje të tjera më përpara nga bashkëpunimi ynë me Gjermaninë, kryesisht në fushën e mbetjeve.

Nëse më lejoni, mund t'ju bëj një historik të shkurtër se si kemi ardhur deri këtu. Që në fillim Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit ka ndërmarrë një studim të hollësishëm të të gjitha bashkive të vendit, menjëherë pas reformës territoriale, me qëllim për të rregulluar dhe përmirësuar situatën e mbetjeve në Shqipëri. Nga ky studim u evidentuan rreth 200 venddepozitime, për të cilat duhen ndërmarrë masa të menjëhershme. Për disa prej tyre ne kemi vendosur që të mbyllen, ndërsa disa të tjera të fillojnë me procesin e parë, që është legalizimi dhe pastaj rehabilitimi në mënyrë që të shërbejnë për të gjithë rajonin dhe qarqet.

Pas këtij studimi ministria ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe një sërë konsultash, sidomos me donatorët. Kemi organizuar disa konferenca me donatorët në mënyrë që të sigurojmë mbështetjen e tyre financiare, sidomos për bashkitë, të cilat janë më vulnerabël dhe nuk kanë mundësi financimi të drejtpërdrejtë. Gjermania ishte donatori i parë që na u bashkua në këtë kontekst për të ndihmuar 6 bashki, të cilat kanë mundësi të pakta ekonomike për të rehabilituar venddepozitimet e tyre. Këto bashki janë: Himara, Peqini, Rrogozhina, Roskoveci, Cërriku dhe Saranda.

Në këtë marrëveshje nga GIZ-i nuk kemi vetëm asistencën teknike, por për herë të parë ai futet në investime direkte për të rehabilituar gjithë zonat. Kjo marrëveshje është 3 vjeçare, ka një vlerë prej 4,5 milionë eurosh dhe do të implementohet nga GIZ-i.

Katër komponentët e marrëveshjes janë: mbështetja për Ministrinë e Turizmit për strategjinë kombëtare të menaxhimit të integruar të mbetjeve, suporti për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit për impiantet, përmirësimin e sistemit të inspektimit të impianteve, për operatorët e mbetjeve të ngurta, si dhe investime direkte në vend-depozitimet për këto 6 bashki.

Niko Peleshi – Fjalën e ka relatorja, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë duke qenë pjesë edhe e Komisionit të Jashtëm, ky projektligj është prezantuar dhe diskutuar edhe në Komisionin e Jashtëm.

E para, dua të komplimentoj ministrinë për lidhjen e kësaj marrëveshje. Gjithashtu, dua të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen për qeverinë gjermane, për ndihmën historike që ka dhënë në zhvillimin e infrastrukturës, në zhvillimin ekonomik e social të Shqipërisë dhe sidomos në fushën e mbetjeve. Fusha e mbetjeve mbetet një çështje shumë e ndjeshme dhe ka më shumë vëmendje nga të gjithë ne. Edhe pas reformës administrative territoriale besoj se bashkitë kanë nevojë për mbështetje, asistencë teknike dhe investime në infrastrukturë për ta adresuar këtë problem. Shuma prej 4,5 milionë eurosh dhe fakti që është një projekt 3 vjeçar, për mua është për t'u vlerësuar, sepse nuk kemi të bëjmë më me asistencë teknike, por me investime reale infrastrukturore.

Dua t'ju komplementoj edhe për përzgjedhjen e bashkive, sepse zakonisht vëmendje marrin bashkitë e mëdha. Në këtë marrëveshje përfitojnë bashki të vogla dhe disa janë të nivelit të dytë, prandaj mendoj se është shumë mirë që u kthye vëmendja edhe ndaj tyre.

Në tre vjet, përveç asistencës teknike, do të ketë investime infrastrukturore dhe ministrisë i ngelet përgjegjësia që të parashikojë buxhet për të gjitha TVSH-të dhe detyrimet sipas ligjit.

Unë kërkoj mbështetjen e të gjithë kolegëve për ta votuar këtë marrëveshje, e cila i shërben zhvillimit ekonomik dhe social, gjithashtu është një kontribut për të adresuar këtë problem kaq të ndjeshëm, siç është ai i mbetjeve urbane.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Kush ka pyetje? Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Ju e dini se si është hierarkia e menaxhimit të mbetjeve urbane, pra është reduktimi, riciklimi, ripërdorimi, incenerimi dhe në fund landfilli. Në 4 – 5 vjetët e fundit ky sektor ka marrë zhvillim dhe parashikohen të ngrihen 2 inceneratorë, që për mua kapaciteti i tyre është më i madh se sa ne gjenerojmë mbetje të djegshme në Shqipëri. Ju mendoni që këto tre inceneratorë komprometojnë kapacitetin riciklues, sepse ato që

riciklohen praktikisht kanë fuqi më të madhe kalorifike dhe për pasojë edhe incerenatori i do, por nuk është ekonomike t'i djegësh. Pra a mendoni që me investimet që janë bërë në industrinë ricikluese komprometohet kapaciteti i kësaj industrie dhe ndesh në një paradoks?

Niko Peleshi – T'i mbledhim të gjitha pyetjet. Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj përfaqësuesit e ministrisë dhe relatoren për shpjegimin!

Falënderim i veçantë është për qeverinë gjermane që vazhdimisht asiston në projektet tona të rëndësishme, në shumë fusha.

Pyetja ime konsiston në një sqarim ndoshta më të madh për mua, por ndoshta edhe për kolegët. Këtu kemi të bëjmë me një marrëveshje, e cila parashikon studimin për disa bashki për landfillet e tyre apo formën që do të gjenden. Eventualisht qeveria gjermane merr përsipër me një shumë maksimale prej 4,5 milionë eurosh që të jetë investitori nëpërmjet GIZ-it. Nga krahu tjetër qeveria shqiptare parashikon që në rast se do të bëhen këto investime, ne do të mbulojmë pjesën tonë të shpenzimeve. A është e saktë kjo?

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – E para, cilat janë bashkitë që përfitojnë? E dëgjova nga relatorja që i tha bashkitë, por në relacion dhe në kontratë, pra në marrëveshjen tuaj nuk janë.

E dyta, në vazhdim të asaj që tha Besniku, në këto investime që qeveria shqiptare bëri për trajtimin e mbetjeve në qytetin e Fierit, Elbasanit dhe Tiranës, të cilat janë mbi kapacitetin e trajtimit të plehrave, për shembull për Fierin, mbase është më mirë që bashkitë e Patosit, Roskovecit, Divjakës, pra të të gjithë qarkut, të sjellin plehrat dhe t'i trajtojnë në Fier dhe bashkitë që janë larg këtyre tre investimeve të qeverisë shqiptare, mund të trajtohen me kredi të të qeverisë gjermane.

Niko Peleshi - Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Musaj.

Nimet Musaj- Faleminderit!

Falënderoj në radhë të parë qeverinë gjermane për mbështetjen që i jep vendit tonë për një nga landfillet më të mëdha, siç është ai i Fierit dhe mbështes kolegun Bitri. Duke parë situatën në zonën e Fierit po vazhdojnë ato problematika me ringritjen e këtij landfilli. Normalisht ne e kemi mbështetur dhe është folur që përveç qytetit të Fierit edhe bashkitë përreth saj, këto mbetje do t'i depozitojnë në këtë landfill, nuk e di sa informacion keni ju, si është situata, pasi kam informacion që vazhdon një gjyq i gjatë për ta pezulluar këtë veprimtari.

Niko Peleshi - Nëse nuk ka pyetje të tjera ia jap fjalën zotit Kamenica për përgjigjet.

Adrian Kamenica – Unë do të doja të qartësoja disa nga pyetjet dhe për disa të tjera do të përgjigjet kolegu.

Është e vërtetë që qeveria gjermane mbulon pjesën e studimeve dhe të rehabilitimit të disa zonave. Ne si ministri do të ndërmarrim për një periudhë trevjeçare kostot, që kryesisht është TVSH-ja. I kemi parashikuar në buxhet, por për shkak se buxheti është në këtë situatë, nuk e di se si do të vijojë viti 2020, por sa të kryhen studimet dhe sa të fillojë momenti i investimit, besoj se do të kalojnë disa muaj dhe do të na japin kohë për parashikimet afatgjata dhe afatmesme.

Lidhur me bashkitë, i përmenda pak edhe në fillim janë përzgjedhur 6 bashki, të cilat janë të nivelit të dytë, jo për t'i ulur, por për të thënë që kanë pak mundësi financiare për t'i menaxhuar mbetjet vetë, që janë: Himara, Peqini, Rrogozhina, Cërriku, Roskoveci dhe Saranda. Pesë bashkitë e para u zgjodhën që të ishin vendedepozitime transitorë. Pastaj do të rehabilitohen që në fazën e dytë të mund të furnizojnë edhe incineratorët edhe landfillët e mëdhenj, por me materialin ashtu siç duhet, të ndarë që në burim. Kurse për bashkinë e Sarandës ne si ministri e Turizmit kemi influencuar duke qenë se gjatë periudhës së verës është një bashki me fluks shumë të madh të turistëve dhe nuk arrin të menaxhojë në mënyrën më të duhur këtë fluks.

Niko Peleshi - Ideja është që Roskoveci apo bashkitë e tjera që do të furnizojnë incineratorin e Fierit do të shërbejnë si stacione transferimi, apo do të bëhet edhe riciklim dhe një pjesë e ricikluar do të shkojë në incinerator?

Fadil Nasufi - Ideja e bashkive të vogla është që ndarja të bëhet që në burim. Ky ka qenë një ndër problemet kryesore dhe vazhdon të mbetet problemi kryesor i të gjitha bashkive. Bashkitë që janë përzgjedhur, do të legalizohen, se nuk kanë leje mjedisore, është "A"-ja e çdo gjëje. Për secilën prej tyre do të përcaktohet edhe sasia që ato gjenerojnë, mundësitë, do të bëhet ndarja në burim, në mënyrë që disa prej tyre të transferohen në incinerator, disa prej tyre në landfill të mbetjeve të ngurta dhe kështu me radhë.

Niko Peleshi - Ndarja do të bëhet në burim apo në landfill?

Fadil Nasufi - Si vend transitor.

Niko Peleshi – Projekti e mbështet ngritjen e landfillit dhe ndarjen në landfill, jo ndarjen në burim, infrastrukturën deri në familje apo në lagje.

Fadil Nasufi - Do të ndikojë dhe ka ndikuar në fazën e parë me investime në disa kosha, me edukimin e të tjera. Pra, pjesa *soft* do të vazhdojë të vijojë, sepse GIZi-i është më

tepër i përqendruar te kjo pjesë. Problemi fillon që në shtëpitë tona jo te koshi, fillon shumë më përpara dhe kjo kërkon kohën e saj që të kulturohemi.

Niko Peleshi - Pra, që ta përmbledh siç e kuptoj unë, projekti mbështet ngritjen e landfillit si infrastrukturë fizike, por edhe si kapacitete *software*-ike apo menaxhimi, ndërkohë financon edhe disa aktivitete që u shërbejnë bashkive për të zhvilluar riciklimin nëse ato do të kenë vullnet.

Fadil Nasufi - Po, absolutisht. Për sa u përket bashkive fillon me studimin, me edukimin, me ngritjen e kapaciteteve brenda vetë bashkive për të influencuar zonën e tyre, që të bëhet ndarja që në burim. Projekti i parashikon të gjitha këto faza që në fillim. Pjesa e fundit është investimi infrastrukturor. Pastaj do të bëhet ndarja për t'u transferuar në venddepozitime të tjera më të mëdha.

Adrian Kamenica - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me pjesën e pyetjes se çfarë ndikimi kanë investimet e qeverisë shqiptare lidhur me ricikluesit, dua të them se tashmë investimet që janë bërë në 3 zona: në Elbasan, në Fier dhe ajo që po ndërtohet në Tiranë janë investime, të cilat janë sipas teknologjive të fundit dhe japin një lloj mundësie akoma më të mirë për çështjen e trajtimit të mbetjeve dhe të djegies së tyre duke pasur parasysh që ndër vite kanë çaluar problemet në lidhje me riciklimin, përpunimin apo ndarjen e të gjitha me radhë.

Janë hartuar aktet ligjore, të cilat u kanë dhënë mundësi dhe autoritet njësisve të pushtetit vendor, por sot e kësaj dite vazhdojnë të kenë problematika të ndryshme lidhur me çështjen e ndarjes në burim, atë të përpunimit apo dhe pjesë të tjera të zinxhirit të mbetjeve. Për këtë arsye është parë e mundur që të ketë një lloj dinamike të tillë. Ministria ka pasur gjithmonë në fokusin e saj edhe mundësinë për bashkëpunim me investitorë të ndryshëm në kuadër të riciklimit. Është në fazat e para. Ka pasur gjithmonë rikuperime, por kryesisht jemi munduar që nëpërmjet këtyre projekteve t'i rrisim sa më shumë kapacitetet, sidomos në njësitë e pushtetit vendor.

Besnik Baraj - Unë thashë, a e pengon kjo sasi që parashikohet të incinerohet procesin e riciklimit? A e penalizon? Unë nuk e di nëse ju keni parasysh se çfarë pjese e mbetjeve urbane mund të digjet? Kapaciteti i tyre me sa di unë, është më i madh sesa ato që parashikohen të digjen. Imagjinoni, sikur të digjen të gjitha, mos të shkojë fare te riciklimi, kapaciteti është më i madh. Nëse do të riciklohet është më ekonomike, sesa të digjet, sepse kjo e fundit kushton. Ajo që fitohet është shumë e vogël në krahasim me atë që investohet për ta djegur. A e pengon riciklimi ose e penalizon më saktë? Kjo bëhet nëse ju

e dini sa është e mundur të digjet, se sa do të riciklohet dhe sa mbetet për t'u ndjekur. Nëse nuk e dini këtë, mësoni, mund ta sillni me shkrim.

Sa individë janë të angazhuar me mbetjet në ministrinë tuaj, që kanë drejtpërdrejt detyrën? Një, dy apo asnjë?

Adrian Kamenica - Është një drejtori e tërë e projekteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj -... apo nuk e keni ju?

Në kohën e PD-së nuk ka pasur asnjë, ka pasur gjysmë, një apo çerek.

Eglantina Gjermeni - Në qeverinë "Rama 1" ishim 3 ministri.

Niko Peleshi - Tri ministri dhe Adriani që merrej nga Kryeministria.

Redi Baduni - Nëse më lejoni të vazhdoj mendimin e sekretarit të Përgjithshëm, aktualisht është vërtet Drejtoria e Konceptimit të Vizibilitetit, por brenda saj ka një sektor të posaçëm, i cili merret kryesisht me pjesën e hartimit të politikave. Aktualisht janë tre dhe unë katër persona. Një pjesë programit, ju e dini tashmë që është ndarë edhe me Ministrinë e Infrastrukturës. Kjo ministri ndjek pjesën e procesit të ngritjes së infrastrukturës për vende depozitimi, pra janë dy aktorë që japin kontribut në pjesën e mbetjeve në tërësi. Janë edhe bashkitë që kanë autoritetin e posaçëm sipas akteve ligjore.

Në këndvështrimin tonë problemi më i madh është menaxhimi nga ana e bashkive. Në vitin 2018 kemi nxjerrë VKM-në nr.391 për masat dhe koston e menaxhimit të integruar të mbetjeve, ku kemi përcaktuar një metodologji shumë të saktë të mënyrës se si konstatohen dhe tariforen mbetjet. Nga rezultatet deri tani shohim se pak bashki e implementojnë këtë VKM. Në këtë kontekst do të donim edhe ndihmën dhe angazhimin tuaj, në mënyrë që të na ndihmoni në këtë proces. Ne kemi marrë pjesë në disa konferenca donatorësh, me qëllim që të kërkojmë ndihmën e donatorëve për të nxitur bashkitë të implementojnë qartë dhe saktë këtë VKM. Kjo do të sillte si rrjedhojë që bashkitë do të kenë mundësi të akumulojnë fonde të mjaftueshme për të menaxhuar mbetjet në bashkitë e tyre, por më e rëndësishme është se ato do të na japin informacionin e saktë se sa mbetje gjeneron secila bashki.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Bitri!

Robert Bitri – Në vizitën që kemi bërë ne si komision në Gjermani, pamë supertrajtimin që u bënin ata mbetjeve urbane dhe duhet pasur parasysh se ky trajtim dhe kjo eksperiencë e tyre duhet të vijë edhe në Shqipëri, por, para se të vijë në këtu, duhet të ndryshojë mentaliteti i shqiptarëve.

Ajo që thotë sekretari i përgjithshëm është me të vërtetë e rëndësishme dhe këta duhet të luftojnë për të gjetur fonde për të propaganduar atë eksperiencë shumë të mirë që kanë gjermanët, por për të mos nxjerrë jashtë loje investimet.

Unë i them Besnikut që ne t'i bëjmë ato qendra më të mira për trajtimin modern të të gjitha mbetjeve.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Musai!

Nimet Musai - Faleminderit!

Unë vij nga bashkia e Fierit ku ka pasur problematika nga më të ndryshmet. Ne kemi pasur mbështetje edhe nga deputeti Bitri në kohën kur është debatuar kjo çështje dhe kryetari i bashkisë ka bërë një punë për t'u vlerësuar.

E njoh mirë këtë problem dhe më vjen mirë që jemi në këtë fazë kur, po japim jo vetëm mbështetje, atë që ju e kërkuat edhe me prezencën tonë në bashkinë e Fierit, por duhet të bëjmë gjithçka që qytetarët të kenë mundësi që hap pas hapi të marrin ato që ne kërkojmë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Fadil Nasufi – Këto buxhete që vijnë nga qeveria gjermane janë shumë të mirëpritura, sepse ato ndihmojnë për të zgjidhur një problem shumë të madh në vendin tonë.

Unë kam përvojë si kryetar bashkie dhe bashkë me Nikon jemi super të specializuar për çështjen e sensibilizimit të komunitetit, për gjendjen aktuale që kemi me përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane, për marrëdhëniet e shpeshta me këto probleme, për eksperiencën punë, vizita dhe prezencë ekspertësh për këto çështje, por edhe pas 30 vjetësh ne do të vazhdojmë të merremi me edukimin, sensibilizimin dhe me implementime modelesh.

Sot kemi dy modele në Shqipëri, modelin e inceneratorëve që financohen nga qeveria shqiptare nëpërmjet koncesionit dhe modelet që ofrojnë donatorët, me landfillle apo me faza të tjera, që fillojnë te studimi i fizibilitetit.

Ministria e Mjedisit, veç gjetjes së hapësirave dhe lutjes për të kërkuar burime financimi për çështjet e përpunimit të mbetjeve urbane dhe bashkëpunimit me bashkitë, duhet të jetë e fokusuar që të krijojmë një model, jo si na e ofrojnë donatorët, në rastin konkret qeveria gjermane, ose në Berat që e ofron qeveria zvicerane, apo diku tjetër Banka Botërore, por ne duhet t'u japim ritëm. Ne duam produkt, nuk duam që të vijnë disa specialistë, të marrin disa paga, të vazhdojmë me edukim. Këto janë të nevojshme, po ne duam produkt, duam fushat e përpunimit të mbetjeve të standardit bashkëkohor.

Në qoftë se janë këto 6 bashki, të mos e kthejmë më kokën prapa për ta, por të mbyllet historia për këtë çështje dhe të fillojmë me të tjerat.

Unë jam me idenë e trajtimit rajonal të mbetjeve urbane, atë që tha edhe Roberti. Kemi probleme me infrastrukturën, me rrugët, por drejt kësaj do të shkojë kjo çështje, pra drejt përpunimit rajonal, pavarësisht nga distancat apo pavarësisht nga infrastruktura e dëmtuar e shumë fshatrave që nuk kanë mundësi t'i çojnë mbetjet në destinacion. Në fund ne duam të kemi produktin.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Bici!

Dritan Bici – Është e qartë përpjekja e komunitetit europian dhe e vendeve të BE-së që edhe ne si një vend ballkanik të bëhemi si ata. Do të thosha se integrimi në Europë duhej të fillonte me mënyrën se si ne trajtojmë mbetjet urbane ose mënyrën se si e mirëmbajmë mjedisin, se në këtë pikë ne jemi shumë keq.

Ne ndoshta edhe eksportojmë në bregdetet e vendeve fqinje mbeturina dhe mbetje të shumta urbane, të cilat në një farë mënyre na ulin edhe autoritetin apo edhe figurën tonë si vend, duke nga trajtuar si pisa (kur shkon në një familje, gjëja e parë që të bie në sy është oborri, nëse është i pastër apo është me lule).

Në këtë aspekt, unë mendoj se ky nuk është problem i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, por është një problem i pushtetit vendor, i cili me organizimin e ri ka kompetenca, ka fonde për trajtimin e këtyre mbetjeve. Të dyja këto modele, qofshin inceneratorë apo landfillë, janë modele të suksesshme, sepse shohim që në qytetet e mëdha, ku ka inceneratorë, është eliminuar problemi i mbeturinave dhe mbetjeve urbane, pavarësisht se çfarë bëhet me problemin e riciklimit. E rëndësishme është të mos kemi plehra dhe ajo që qeveria po ndërmerr në qarkun e Durrësit është mbyllja e një plazhi shumë të madh në Portoromano, ashtu sikurse edhe në Tiranë, ashtu sikurse edhe në Elbasan, ashtu sikurse po veprohet në Fier unë do t'i cilësoja si suksese.

Njëkohësisht, duke qenë se vij nga pushteti vendor, do të bëja me shumë faj pushtetin vendor për sa i përket kësaj çështjeje, sepse të gjitha mbeturinat fillojnë e hidhen fshatrave, nga rrëketë këto mbetje shkojnë nëpër lumenj e kështu me radhë.

Përderisa pushteti vendor bën tendera të fuqishëm për mbetjet urbane, edhe përgjegjësia duhet të jetë e tij dhe ata duhet t'i kërkojnë shtetit mbështetje për ama nuk mund të vazhdojmë në këtë mënyrë, sepse sipas meje, mbrojtja e mjedisit fillon në fshatra, mbrojtja e mjedisit fillon në male, si për sa u përket përmbytjeve, si për sa u përket mbetjeve urbane e çdo gjëje tjetër.

Unë jam midis dy brezave, ndaj e di se edhe në kohën e Enver Hoxhës ndërtoheshin me kamionë prita malore, mbilleshin pemë në male, me qëllim që të mos përmbyteshin fushat. Prishja e këtyre kamionëve, se fshatarët i morën për hekur dhe ndërtuan shtëpitë në

Durrës, ato shtëpitë që u shembën kur ra tërmeti. Prishja e kamionëve, prerja e pyjeve nëpër fshatra, duke mos pasur as ndonjë qendër komune, ish qendër komune, se tashti është bërë një e vetme, duhet të trajtohen me ato variante, sepse t' i çosh nga Gramshi në Elbasan, për shembull, ka kosto dhe duhet financiar, duhet rritur ai tenderi. Fare mirë mund të trajtohen në vendgrumbullime, deri sa çdo gjë të shkojë në vendin e vet.

Sipas meje, e rëndësishme është që Ministria e Mjedisit të jetë një kontrollore e rreptë ndaj pushtetit vendor, me qëllim që të rritet përgjegjësia e pushtetit vendor në lidhje me këtë problem.

Unë për vete nuk e shoh zi situatën, por e shoh me optimizëm, sepse hapat e ndërmarrë nga qeveria jonë vitet e fundit, kanë mundësuar që në shumë qytete problematike, si Elbasani, Tirana, Fieri, apo Maliqi të bëhen investime shumë të fuqishme, të cilat po e dispijlojnë këtë proces.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera? Diskutime?

Mirë atëherë, para se të kalojmë në votim, dua t' i kërkoj përfaqësuesve të ministrisë, që të mbajnë shënim një informacion të kërkuar nga zoti Baraj, të cilin po e përmbledh: zoti Baraj, mund të më korrigjoni nëse e kam gabim, ka kërkuar informacion lidhur me sasinë e llogaritur të mbetjeve për të shkuar në incenerator. Pastaj, nëse ky zhvillim, pra ndërtimi i landfilleve, duke përfshirë edhe proceset e riciklimit, që do të thotë reduktim i mbetjeve që shkojnë në incenerator, është parashikuar në plan biznes me inceneratorët apo jo.

Ju lutem, do të donim një informacion me shkrim, të cilin mund ta drejtoni pranë komisionit tonë deri javën tjetër, pra pas një jave.

Siç tha edhe zoti Bici, edhe zoti Nasufi, unë do të thosha se pa dyshim, të gjitha investimet janë të përshëndetura, sepse janë zhvillime pozitive, por kemi edhe konfuzione. Ju takon juve si ministri, që ta qartësoni pak më mirë politikën tonë të mbetjeve. Pra, cila është radha, cili është prioriteti? Kur them prioriteti, e kam fjalën ndërmjet metodave të trajtimit të mbetjeve, cili model i shkon më shumë stadi tonë të zhvillimit ekonomik, fuqisë sonë dhe të bashkive tona për ta përballuar me buxhet? Sepse, ka zgjidhje që mund të jenë shumë të mira, por kërkojnë buxhet të lartë, sikundër ka zgjidhje që janë të mira, por janë edhe të përballueshme nga buxhetet tona.

Nga eksperiencia ime në bashkinë e Korçës, më kujtohet që jemi menduar gjatë, pavarësisht se zoti Nasufi kërkoi një çikë më shumë ritëm, gjë për të cilën mbase ka të drejtë, por unë them se ia vlen të shpenzojmë kohë, energji e parë, paraprakisht, për të përcaktuar modelin, për të bërë fizibilitetin, para se të shkojmë në investimet fizike. Sepse, për fat të keq,

në të gjithë Shqipërinë kemi dhjetëra, madje qindra miliona euro të investuara në infrastrukturë fizike, por që nuk janë vënë në funksionim. Kemi disa dështime, të cilat duhet t'i pranojmë, në fusha të ndryshme. Për shembull, kemi impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura përgjatë pothuajse gjithë bregdetit shqiptar, të cilët nuk punojnë, nuk kanë punuar asnjë ditë. Janë ndërtuar shumë mirë fizikisht, janë dorëzuar, por kanë ceduar, sepse ne nuk kemi menduar që në fillim si do të menaxhohen dhe si do të funksionojnë. Kanë ceduar për gjëra fare të vogla, për gjëra banale: për shembull, për një kanal, që duhet të lidhë sistemin e kanalizimeve me impiantin e ujërave të përdorura; ose për shkak se nuk është përcaktuar se kush do ta menaxhojë: do ta menaxhojë bashkia impiantin e ujërave të përdorura, do të menaxhohet në mënyrë rajonale: kështu, ka ngelur aty. Po ashtu, ka edhe dështime të tjera.

KfE-ja meriton një falënderim shumë të madh, sepse është nga ata donatorë apo partnerë, që nuk investojnë asnjë lek – ndonëse pjesa më e madhe janë kredi, pra janë para që i marrim dhe i shlyejmë ne – nuk investojnë asnjëherë në rast se nuk binden dhe nuk ndërtojmë paraprakisht kapacitetet menaxhuese. Këtë e kam nga eksperiencia.

Tani, për t'u kthyer aty ku e lamë, se cili është modeli më i përshtatshëm, në Korçë kemi ndërtuar një zgjidhje rajonale për mbetjet. Të gjitha bashkitë janë bërë bashkë, kanë krijuar një shoqëri aksionere, me aksione në raport me popullsinë. KfE-ja na ka mbështetur për të ndërtuar një landfill modern sanitar, landfilli i Maliqit, i cili tani funksionon për mrekulli dhe i shërben gjithë rajonit. Kjo është një zgjidhje, e cila jo vetëm funksionin nga pikëpamja infrastrukturore fizike, por është edhe ekonomike. Pra, e mbajnë shpatullat e bashkive tona.

Për zgjidhjet e tjera, në mënyrë shumë miqësore ju sugjeroj që ju, si ministri, të merrni pak më shumë lidhshmëri, dhe të na bëni të gatshme modelet, dhe sa kushton çdo model, sa kushton inceneratori për një rajon, përballohet dot një incenerator nga një bashki, apo do zgjidhje rajonale? Kush është ajo që quhet *break even point*? Pra, sa është minimumi i sasisë që duhet të furnizojë një incenerator, që ai të jetë rentabël apo fizibël? Sepse, me shumë të drejtë, çdo qeveri përpaket të ecë përpara, çdo Kryeministër kërkon rezultate, qytetarët po ashtu presin rezultate, dhe nganjëherë ne bëjmë zgjidhje të nxituara, në rast se na mungojnë këto modele.

Ky është një sugjerim miqësor.

Sa i përket përgjegjësisë që ka pushteti vendor, padyshim që edhe në legjislacionin tonë, e kështu duhet të jetë, është pushteti vendor përgjegjës për mbledhjen, trajtimin, riciklimin e mbetjeve urbane. E vërteta është se buxhetet e bashkive tona, Dritan, janë të pamundura për të përballuar investimet e mëdha që kërkon infrastruktura urbane, prandaj

kërkon patjetër mbështetje nga qeveria qendrore. Në fakt, kërkohet edhe një guxim i madh për të rritur tarifën e mbetjeve. Kjo nuk është shumë popullore, nuk është shumë elektorale ta thuash, por e vërteta është se po nuk rritën tarifën e mbetjeve, bashkitë tona nuk do të kenë dot mundësi të paguajnë qoftë edhe kostot e landfillit, le pastaj të inceneratorëve, që me sa di unë, i kanë më të larta.

Këtu, ne edhe mund të ndërmarrim një iniciativë ligjore për të përcaktuar dyshemetë e për t'i ndihmuar bashkitë, sepse kryetarët e bashkive bëjnë me të drejtë ato llogaritë e tyre elektorale, ndaj nuk guxojnë shumë të ndërmarrin rritje tarifash, por edhe pa tarifa nuk përballohet dot kostoja.

Unë këto mendime kisha. Në qoftë se s'ka ndonjë diskutim tjetër, le të kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik 2018, për projektin Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit””.”

Kush është dakord në parim?

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet në parim!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord?

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Neni 2. Kush është dakord?

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet edhe neni 2!

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord?

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet!

Shumë faleminderit! Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë!

E mbyllim këtë çështje, pra seancën për trajtimin e kësaj çështjeje.

Fillojmë menjëherë seancën tjetër, në lidhje me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Kemi një projektligj tjetër. Projektligjin që fillova të lexoja, e kemi në orën 12.

Pra, kemi për shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19. 5. 2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.”

Relatore është zonja Gjermani.

Zonja Gjermani, fjala për ju!

MBYLLET MBLEDHJA